



MISIONI SHQIPTAR

E Lumja Nënë Tereza

Blessed Mother Teresa Albanian Mission
739 Browns Line, Etobicoke, Ontario M8W 3V7
Tel. 416 503 4509 dhe 647 558 9382
www.misioninenetereza.com

Çdo të dielë në orën 12:00 Rruzarja dhe Mesha Shenjte

Drejtësi

21 Shtator 2014



A Në atë kohë, Jezusi u tregoi nxënësve të vet këtë shëmbëlltyrë: “Mbretëria e qiellit është e ngjashme me atë zot shtëpie, i cili doli herët në mëngjes që të gjejë punëtorë për vreshtin e vet. E, si u godit me punëtorët nga një denar në ditë, i çoi në vreshtin e vet. Pastaj doli edhe rreth orës tre, pa do të tjerë duke ndenjur të papunë në treg e u tha: ‘Shkoni edhe ju në vreshtin tim e do t’ju jap sa të jetë e drejtë.’ Shkuan edhe ata. Prapë doli rreth orës gjashtë dhe orës nëntë e bëri ashtu. Doli përsëri rreth orës njëmbëdhjetë, gjeti tjerë që po rrinin të papunë dhe u tha: ‘Përse rrini këtu të papunë gjithë ditën?’ Ata i përgjigjën: ‘Sepse askush nuk na mori në punë.’ Ai u tha: ‘Shkoni edhe ju në vresht!’ Si u bë mbrëmje, i zoti i vreshtit i tha kujdestarit të vet: ‘Thirri punëtorët dhe jepu pagën – fillo prej atyre të fundit e deri në të parët.’ Erdhën kështu ata të të njëmbëdhjetës orë e morën secili nga një denar. Kur erdhën të parët, menduan se do të marrin më shumë. Por edhe ata morën nga një denar. Duke e marrë ankoheshin në zotshtëpinë e thoshin: ‘Këta të fundit punuan vetëm një orë e ti i barazove me ne që mbartëm mundin e ditës e vapën.’ E ai i përgjigji njërit prej tyre: ‘Mik, s’po të bëj padrejtësi! A nuk u godite me mua nga një denar? Merr sa të përket e nisu! Unë dua t’i jap edhe këtij të fundit sa ty! A nuk kam të drejtë të bëj me pasurinë time si më pëlqen mua? Vallë a duhet të jesh ti smirëzi pse jam unë i mirë?’. Kështu të fundit do të jenë të parët, e të parët të fundit!” *Mt 20, 1-16*

Mesha Shenjte....

Mesha kremtohet çdo të dielë në orën 12:00 te Kisha: Our Lady of the Miraculous Medal, **739 BROWN'S LINE, Etobicoke**, M8W 3V7 (Browns Line & Evans Avenue) Phone (416) 255-2721. Kisha ndodhet menjehere mbrapa Slovenia Credit Union. Public transport: Brown's Line at Coules Court North Farside (15 m N) 123. Per me shume informacion shih faqen internet: **www.ourladyofmm.com** ose kunsultu harten e ketushme.



Kalendari liturgjik...

22 Shtator Shen Toma nga Villanueva
23 Shtator Shen At Piu nga Pietralcina
25 Shtator Shen Vincenc Strambi
26 Shtator Shenjterit Kozma dhe Damiani
27 Shtator Shen Vincenc De Pauli



Hakun e Kishes per vitin 2014

e kane dhene:

Aleks	Coku	Mhill	Ftoni
Altin	Miri	Ndok	Macaj
Angjelin	Kaçaj	Ndue	Cacaj
Anton	Malaj	Nik	Biçi
Anton	Tinaj	Nush	Kacaj
Anton	Brunga	Nush	Dokaj
Arben	Toma	Paulin	Lukani
Arben	Pepa	Petrit	Ujka
Arben	Marku	Pjerin	Kalaj
Ardian	Preçetaj	Pjeter & Bep	Dreshaj
Arjana	Nati	Prek	Lekaj
Astrit	Simeqi	Prek	Frani
Aurel	Vata	Prek	Spaqi
Beniamin	Hasko	Prek	Kaçaj
Edmond	Kacorri	Preke	Gjonaj
Eduard	Shkreli	Roza	Kalaj
Erion	Tase	Rrok	Gjoni
Flobenc	Shkalla	Sander	Kosmaci
Gjergj	Nikolla	Sokol	Ujka
Ladi	Lumaj	Sokol	Gashaj
Lekë	Tarazhi	Tom	Ulaj
Leks	Dragu	Ton	Vocaj
Luigj	Narkaj	Valmir	Gjinaj
Luk	Gjolaj	Vaso	Gjuravcaj
Marash	Martinaj	Viktor	Pleti
Marin	Muzhani	Viktor	Gjokaj
Mario	Martini	Vitor	Mernacaj
Mark	Shkreli	Vladimir	Doda
Martin	Pjetri	Zef	Deklaj

Zoti ua shperblefte ne te mira e ua shtofte!

Per Hakun e Kishes: Vini re...

Sikur eshte caktuar me vendim te shumices se anetareve **Haku Vjetor i Kishes** eshte 500 dollare dhe mund te jipet ne cash, check ose me credit card (shih faqen website misioninenetereza.com Donate Now for Blessed Mother Teresa Mission), **ne nje shume te vetme ose pjese pjese** gjate vitit. **Ata te cilet per arsye te ndryshme jane ne veshtiresi te kontaktojne drejperdrejt me famullitarin.**



Prayer of Mother Teresa



DEAR JESUS, help me to spread Thy fragrance everywhere I go. Flood my soul with Thy spirit and love. Penetrate and possess my whole being so utterly that all my life may only be a radiance of Thine. Shine through me and be so in me that every soul I come in contact with may feel Thy presence in my soul. Let them look up and see no longer me but only Jesus. Stay with me and then I shall begin to shine as you shine, so to shine as to be a light to others.

Papa në audiencën e përgjithme: Kisha është katolike e apostolike, për udhë drejt botës



Kisha është universale, sepse lindi 'për udhë', domethënë, misionare, e lidhur gjithnjë me zinxhirin e gjatë, që zu fill nga kumtimi i parë i Dishepujve. Kështu i shpjegoi Papa, në audiencën e përgjithshme, mbajtur sot paradite në Sheshin e Shën Pjetrit, dy karakteristikat e veçanta të Kishës, që është "katolike" e "apostolike". Papa e përfundoi audiencën duke u kërkuar besimtarëve ta shoqërojnë me lutje gjatë shtegtimt të tij në Shqipëri, të dielën e ardhshme. Po të kishte qenë një rreth për pak të zgjedhur, nuk do të kishte pasur një histori prej dymijë vjetësh e një shtëpi të madhe, sa bota. E, falë pasojave të Rrëshajëve, është bashkësi që i flet

të gjitha gjuhët e gjindet gjithkund. Papa Françesku u shpjegoi shtegtarëve, mbledhur në audiencën e përgjithshme, kuptimin e epiteteve kryesore të Kishës. Katolike universale, domethënë e krijuar nga Shpirti i Shenjtë, që e bëri misionare qysh prej orës zero - e apostolike - sepse e mbështetur mbi dëshminë e Dymbëdhjetë Apostujve, hallkat e para të zinxhirit të gjatë të fesë: **“Fjala e Hyjit sot lexohet në të gjitha gjuhët, të gjithë e kanë Ungjillin në gjuhën e vet, për ta lexuar. E kthehem tek i njëjti koncept; është gjithnjë mirë ta marrim me vete një Ungjill të vogël, ta kemi në xhep, në çantë e gjatë ditës, të lexojmë një pjesëz. Kjo na bën mirë. Ungjilli është i përhapur në të gjitha gjuhët, sepse Kisha, kumtimi i Jezu Krishtit Shëlbues, jehon në botën mbarë. E prandaj thuhet se Kisha është katolike, sepse është universale”**. Për Papën Françesku, katoliciteti, në thelb, është porta që një ditë u rrotullua mbi çivitë e Çenakullit e u hapi dishepujve udhën për të dalë, për t’u nisur mbë udhë drejt botës së madhe: **“Nëse Apostujt do të kishin mbetur të mbyllur aty, në çenakull, pa dalë për ta çuar kudo Ungjillin, Kisha do të ishte vetëm Kishë e këtij populli, e këtij qyteti, e këtij çenakulli. Por të gjithë dolën nëpër botë, nga çasti i lindjes së Kishës, nga çasti kur zbriti mbi ta Shpirti i Shenjtë. E prandaj Kisha lindi ‘për udhë’, në dalje, domethënë, misionare”**. Prej këndej amullia nuk ka të bëjë me ADN-në e Kishës. Apostujt vihen për udhë, arrijnë në toka të largëta, themelojnë atje kisha të reja. E të gjithë ne, sot, kujtoi Papa Françesku, vijojmë udhën e këtij grupi Apostujsh, që mori Shpirtin e Shenjtë e, pastaj, kapërceu pragun e portës e doli e u nis për udhë për të predikuar: **“Është Shpirti i Shenjtë, që kapërcen çdo kundërshtim, që fiton mbi tundimin për t’u mbyllur në vetvete, ndërmjet pak të zgjedhurve, e për ta mbajtur veten si mbartës të vetëm të bekimit të Hyjit. Nëse, për shembull, disa të krishterë e bëjnë këtë e thonë: ‘Ne jemi të zgjedhur, vetëm ne!’, në fund vdesin. U vdes shpirti një herë, pastaj edhe trupi, sepse nuk kanë jetë, nuk janë të aftë për të krijuar jetë, njerëz të tjerë, popuj të tjerë; nuk janë apostolikë”**. Atëhere mund të themi se të bësh pjesë në një Kishë katolike e apostolike, do të thotë, nënvizoi Papa, ta kesh fort për zemër shëlbimin e mbarë njerëzimit, të mos jesh indiferent e as i huaj, kur bëhet fjalë për fatin e vëllezërve të shumtë, në pritje, por ta hapësh zemrën, të jesh solidar ndaj tyre. Do të thotë të jesh i vetëdijshëm se feja jonë lidhet me zinxhirin e gjatë, që vjen nga Apostujt e pasardhësit e tyre, kumtues pa kufij të Ungjillit. E këtu, Papa Françesku u ndalua posaçërisht tek jeta heroike e shumë e shumë misionarëve e misionareve që, përsëriti, e lanë atdheun e tyre, për të shkuar larg, në të katër anët e botës e për t’ua çuar Krishtin

popujve, duke kumtuar Ungjillin e Tij në të pesë kontinentet. **“Më thoshte një kardinal brazilian, që punoi për shumë kohë në Amazonë, se kur shkon në ndonjë vend, në ndonjë fshat a qytet të Amazonës, viziton gjithnjë varrezat e atje shikon varret e këtyre misionarëve, priftërinjve, rregulltarëve e rregulltareve, që shkuan ta predikojnë Ungjillin: apostuj. E mendon: të gjithë këta mund të shenjtërohen menjëherë, e me të drejtë: lanë gjithçka kishin për ta kumtuar Krishtin deri në skajin më të fundmë të botës(...). Ta falënderojmë Zotin për këtë”**. E falënderimi u përsërit edhe në përshëndetjen e shtegtarëve të gjuhës arabe e të Lindjes së Mesme, të cilët Papa i quajti bij të këtyre tokave të shenjta që, pavarësisht nga vështirësitë, vijojnë të jenë mbartës guximtarë e gazmorë të mesazhit të shëlbimit, të së vërtetës e të bekimit.

LUTJA KUSHTUAR VIKTIMAVE TË DIKTATURËS KOMUNISTE

Lutja është formuluar nga Drejtësi dhe Page, Shkodër dhe është miratuar nga Imzot Angelo Massafra



*Të Lutemi o Zot
Sot ne këtë ditë
simbolike
Në këtë vend
dhimbjesh
Për ata të cilëve jeta
u humbi
Në qelitë e ftohta
Mes lotësh e lutjesh
të psherëtira nën zë
Lutemi për ata që
u gllabëruan nga
galeritë
Në punë skllavëruese
Me të vetmin
shpërblim, bukë e ujë
Lutemi edhe për ata*

*që nuk patën një vend të denjë
ku të prehen
Që u groposën si sende në këto shpate
Me një shishe në gjoks e një numër mbi kokë
Lutemi të kene gjetur paqen
Pranë teje, në amshim
Lutemi edhe për ata që mbijetuan
Të sflitur, të tjetërsuar ne trup e shpirt
Të harruar e të përbuzur
Të lutemi hidh një rreze shprese
në vitet e tyre të fundit
Që pa pengje t'i mbyllin sytë
Lutemi edhe për shpirtrat e atyre
Që nga djalli u mashtruan
dhe munduan vëllezërit e motrat e tyre
të pafajshëm
Lutemi edhe për ata
Që lakmia u errësoi sytë
E për përfitime boshe
Lëshuan akuza e dëshmi të rreme
Dhe u vodhën jetën vëllezërve e motrave të tyre*

Lutemi edhe për ata
 Të lëkundurit e të dobët
 Që jetuan me frikë në zemër
 E që për të shpëtuar veten
 Fundosën të tjerët
 Lutemi që në çastet e tyre të fundit
 Të kenë gjetur pendesën
 Që barra e mëkateve
 Të mos u rëndojë shpirtin në amshim
 Lutemi që çfarë ndodhi
 Kurrë më të mos përsëritet
 Po ashtu te Lutemi o Zot
 të na japësh urti, forcë dhe guxim
 Ta mbajmë të gjallë kujtimin e tyre
 E të ecim pa u ndalur përpara
 Në shtigjet e vështira të pajtimit. Amen!

Rocco C Lofranco LLB

The Madison Centre
 4950 Yonge Street Suite 600
 Toronto ON M2N 6K1

416 223 8333

Toronto • Scarborough • Mississauga • Brampton




LOFRANCO CORRIERO
 PERSONAL INJURY LAWYERS



Radio Maria!
 Degjoje drejtpërdrejt ne
www.radiomaria.al





SUTTON WEST REALTY INC., BROKERAGE



Miranda Bimo
 Sales Representative

Bus: 416.240.1000
 Cell: 647.294.8826
 Fax: 416.240.1603

300-5415 Dundas St. W.
 Toronto ON, M9B 1B5

mirandabimo@gmail.com

Independently Owned and Operated

Violeta Selmanaj, Broker
Tony Selmanaj, Sales Representative

Per Shitje, Blerje, Gera Shtepi, Condo A Po
 Biznese Lutemi Na Kontaktoni (Shume Vite
 Eksperience Ne Toronto Dhe Rrethina)


In House Mortgage Broker 25 Years
 Experience Special Rates Through
 Violeta and Tony Selmanaj For Fully
 Qualified Applicants.

* Call for Details

Direct (416) 553-5044
 Office: (905) 279-8300
 Email: vselmanaj@trebnet.com

ROYAL LEPAGE Realty Centre, Brokerage
 2180 Hurontario Street Mississauga, ON L5B 1M8





Kramer's Bar & Grill
 1915 Yonge St Toronto
Per Festa Private
 Kontakto Arben Toma
 Tel : 647-887-9058

BEQIRI



Ylli BEQIRI CPA.CGA

PROFESSIONAL CORPORATION

Tel: 416-854-9156
 Fax: 1-888-838-7736

974 The Queensway,
 Toronto ON M8Z 1P6

ybeqiri@sympatico.ca
www.beqiriaccounting.com





Produkte Shqiptare!
 Prodhuar dhe importuar nga Shqiperia.

- Fergese
- Reçel fiku, pjeshke, kumbulle, qershie
- Marinade Speci, kastravec, lakre
- Specia te pjekur
- Specia djeges
- Panxhar i kuq
- Komposto kumbulle
- Uje Mineral Tepelene
- Coffee Skenderbeu



www.kodra.org